

Njoftim për shtyp

për miratimin e udhëzuesit për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën

Komisioni i Konkurrencës ka miratuar udhëzuesin për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën.

Ky udhëzues rekomandohet të përdoret në punën e të gjithë organeve të administratës qendrore e vendore, si dhe enteve rregullatorë për të vlerësuar ndikimin mbi konkurrencën për çdo projekt-akt normative të propozuar.

Sipas ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", organet e administratës qendrore dhe vendore kanë detyrimin ligjor që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me:

- a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
- b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
- c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Udhëzuesi për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën do të jetë një mjet i domosdoshëm edhe për punën e vetë Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 70 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", ku përcaktohet roli i Autoritetit për rregullimin dhe reformën rregullatore. Sipas këtij neni, Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson në veçanti barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti i Konkurrencës bën rekomandimet përkatëse.

Udhëzuesi për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën pritet që të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e të gjithë legjislacionit shqiptar në drejtim të sigurimit të një konkurrence të lirë e efektive në treg si dhe për një qëndrim më aktiv të institucioneve të tjera..